



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:059455

Datë: 05.04.2019

Numri i dokumentit: 00270297

P.nr.305/2015

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lëndën penale sipas P.Th. në Prizren, aktakuzës **PP/II nr.3227/14 të datës 21.04.2015**, ndaj të pandehurit I B nga fsh. S Komuna S, i akuzuari për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-se, në prezencë të prokurorit te PTH-së, në Prizren Beqë Shala dhe te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar, te mbajtur me dt.26.03.2019, mori publikisht shpalli dhe me date 02.04.2019 përpilo këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari I B, nga i ati E, e ëma Gj, e lindur K, i lindur më, me vendbanim në fsh. S, me numër i martuar, baba i tre fëmijëve, ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, me pare i pa dënuar, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovë.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse prej datës se pa vërtetur e deri me datën 13.10.2014 ne ore te pa vërtetur ne fshatin S Komuna S, merr përdorë duke u furnizuar përmes rrjetit përçues te rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit te autorizuar, ne atë mënyrë qe shfrytëzon energjinë elektrike me njësor elektrik ku përçuesi i fazës se trete nuk është ne rregull, dalja e fazës se trete është kyq ne dalje te fazës se trete ne kahja te kundërt, ashtu qe bene shfrytëzimin e pa autorizuar te energjisë elektrike, me q rast te dëmtuarës Keds Divizioni i rrjetit – distrikti ne Prizren i shkakton demë material ne vlerë te energjisë se shpenzuar ne shume prej gjithsejtë 98.48 euro.

Me këtë ka kryer veprën penal vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-se.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 51, 52, 73, 74 KP si dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 320 KPK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Duke i a caktuar dënimin me burgim prej 2 (dy) muajve, dhe dënimin me gjobe ne shume prej 100 (njëqind) euro, te cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse në kohën e

verifikimit prej një viti, i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës konform nenit 453 par. 4 të KPP-ës.

Udhëzohet pala e dëmtuar, **KEDS-si –Distrikti** në P që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në kontest të rregullt civil.

A r e s y e t i m

PTH-e me aktakuze, **PP/II. nr. 3227/14 të datës 21.04.2015**, ndaj të pandehurit I B nga fsh. S komuna S, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-se, të cilin gjatë seancës së shqyrtimit fillestare e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Beqë Shala, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuze, që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin e sotëm edhe me vet pranimin nga ana e të akuzuarit ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 të KPP-së në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, është bërë vullnetarisht në shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe provat materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH-së në Prizren.

Gjykata po ashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsytet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit penal, andaj Gjykata ka vendosur se i akuzuari është fajtor dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-ës, të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për bazë se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, është përnduar për veprën e kryer, është hera e parë që bie ndesh me Ligjin, kurse rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE

G j y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.